



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr.45, datë 13.06.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 30, DATË 18.07.2017 "PËR  
LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË"**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 30, datë 18.07.2017, "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë";
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë ka aplikuar me anë të shkreses nr. 630 prot. datë 25.05.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit teknik, konkretisht:
  - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Drejtuesi teknik plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e Licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 30, datë 18.07.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjellës Kanalizime Berat-Kuçovë" bëhen këto ndryshime:

"Drejtuese Teknike Aleksandra Kllapi"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**